

**AKT THEMELIMI
I SHOQËRISË "ILIFE PRO" Sh.p.k.**

Sot, më datë 21/03/2023,

Z. Symon Atzeni, shtetas Italian, lindur në Carbonia (CA), më 28/12/1977, banues në Itali, në adresë Via Cagliari, 48, mbajtës i dokumentit Kartë identiteti me nr. AY 5368361, madhor e me zotësi të plotë juridike e për të vepruar;

Në përputhje me ligjin 9901, datë 14.04.2008, "Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare" (i ndryshuar) dhe ligjit nr. 9723, dt. 03.05.2007, "Për Qendrën Kombëtare të Regjistrimit", ka vendosur të themelojë një Shoqëri me Përgjegjësi të Kufizuar të emërtuar "ILIFE PRO" Sh.p.k. (më poshtë referuar si "Shoqëria").

**NENI 1
EMËRTIMI**

Themelohet një shoqëri e së drejtës shqiptare me përgjegjësi të kufizuar me emërtimin "ILIFE PRO" Sh.p.k.

**NENI 2
SELIA**

Selia zyrtare e Shoqërisë ndodhet në: Rruga "Komuna e Parisit", Hyrja 1, Apartamenti 7, Zona Kadastrale 8260, Tiranë.

Asambleja e ortakëve mund të themelojë filiale, seli dytësore ose njësi të tjera operative si dhe të transferojë selinë e shoqërisë në një adresë apo qytet tjetër.

**NENI 3
KOHËZGJATJA**

Kohëzgjatja e shoqërisë do të jetë për një afat të pacaktuar, përveç zgjatjes ose prishjes së mëparshme të saj sipas vendimit të Asmablesë së Ortakëve.

**NENI 4
OBJEKTI**

Shoqëria ka për objekt të veprimtarisë:

- Import-eksport, tregti me shumicë dhe pakicë, prodhim artikujsh brenda dhe jashtë vendit, si: dritare, vetrata duralumini, matriale duralumini, xhami, plastike, kartonxhes gipsi, fasada dhe vetrata te ndryshme, punime fasadash duroalumini, druri, hekuri, etj;
- Përpunim, prodhim, shitje dhe transport për vete dhe të tretë, brenda dhe jashtë vendit, të artikujve të ndryshëm të duraluminit, të profileve të ndryshme dhe aksesoreve të tyre si dhe të pajisjeve të nevojshme për reparimet e përpunimit;
- Import-export të lëndës së parë;



- Shoqëria mund të kryejë çdo aktivitet industrial, tregtar, financiar, me pasuri të luajshme dhe të paluajshme, të cilat do të vleresohen të nevojshme për arritjen e objektivit të shoqërisë, në Shqipëri dhe jashtë saj; në marrjen e aksioneve dhe interesave të drejtpërdrejta dhe të tërthorta në çfarëdo forme tjetër në shoqëri dhe ndërmarrje të tjera, në Shqipëri dhe jashtë saj, që kryejnë aktivitete të cilat mund të jenë edhe të ndryshme nga objektet analoge, të ngjashme ose në çdo rast të lidhur me të tija;
- Përveç kësaj në përputhje me legjislacionin shqiptar, shoqëria mund të kryejë çdo aktivitet tjetër, në Shqipëri dhe jashtë saj, që lidhet me objektin e sipërpërmendur dhe që nuk është i ndaluar nga ligji i zbatueshem në Republikën e Shqipërisë;
- Shoqëria në ushtrimin e aktivitetit të saj, do të marrë të gjitha autorizimet e lejet/licencat e nevojshme pranë institucioneve publike shqiptare, dhe do të mbështetet në rregullat dhe normat në fuqi në lidhje me ushtrimin e veprimtarisë së saj të rregullt ekonomike.

NENI 5

KAPITALI THEMELTAR

Kapitali themeltar është i përbërë nga kontributi në të holla i ortakut të vetëm themelues në vlerën 1,000,000 Lekë (një milion) Lekë dhe është i përbërë nga 1 kuotë.

Kapitali themeltar ndahet si më poshtë:

- **Z. Symon Atzeni**, zoteron 1 kuotë, me 100% të kapitalit themeltar, me 1 (një) pjesë me vlerë 1,000,000 Lekë (një milion) dhe 1,000,000 Lekë (një milion) të kapitalit themeltar.

Kapitali themeltar mund të zmadhohet nëpërmjet kontributeve të reja në para ose në natyrë, sipas vendimeve të asamblesë së ortakëve të marra më shumicat të parashikuara për ndryshimin e këtij statuti.

NENI 6

ORGANET E SHOQËRISË

Organet e shoqërisë përbëhen nga Asambleja e ortakëve dhe Organi administrativ.

- Asambleja e ortakëve është organi vendimmarrës i shoqërisë e cila vepron në përputhje me Statutin e shoqërisë dhe legjislacionin në fuqi.
- Asambleja e Përgjithshme emëron një ose më shumë persona fizikë si administratorë të shoqërisë.
- **Z. Symon Atzeni**, shtetas Italian, lindur në Carbonia (CA), më 28/12/1977, banues në Itali, në adresë Via Cagliari, 48, mbajtës i dokumentit Kartë identiteti me nr. AY 5368361, madhor e me zotësi të plotë juridike e për të vepruar, caktohet Administrator i shoqërisë.
- Kohëzgjatja e mandatit të Administratorit/ëve është 5 (pesë) vjet, me të drejtë ri-emërimi.

NENI 7

LEGJISLACIONI I APLIKUESHËM

Aktiviteti i shoqërisë do të rregullohet nga dispozitat e statutit të shoqërisë, si dhe nga të gjitha dispozitat ligjore në fuqi në Republikën e Shqipërisë.

NENI 8

DISPOZITA FINALE

Ky Akt Themelimi hartohet në 2 (dy) kopje origjinale në gjuhën Shqipe dhe atë Italiane me vlerë të njëjtë ligjore.

Përmbajtja e Aktit të Themelimit u lexua dhe nënshkrua nga Ortaku themelues i shoqërisë duke autorizuar **Administratorin Z. Symon Atzeni**, për të kryer të gjitha veprimet e nevojshme për regjistrimin e shoqërisë pranë Qendrës Kombëtare të Biznesit (QKB) në Tiranë.

ORTAKU THEMELUES

SYMON ATZENI

